

L I G J
Nr. 8528, datë 23.9.1999

PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME GJI
(Ndryshuar me ligjin nr. 58/2013, datë 14.2.2013; nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të nxitë dhe të mbrojë të ushqyerit me gji, si dhe të rregullojë tregtimin e zëvendësuesve të qumështit të gjirit për të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijëve.

Neni 2

(Shtuar paragraf në shkronjën “ç” dhe shkronja “e” me ligjin nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

Në zbatim të këtij ligji, termat vijues kanë këto kuptime:

a) “Reklama” kuptohet reklamimi me çdo mjet për nxitjen, shitjen ose për konsumin e prodhimeve të zëvendësuesve të qumështit të gjirit.

b) “Ushqim plotësues” kuptohet çdo ushqim i përshtatshëm, i paraqitur për ushqim shtesë të qumështit të gjirit, formula për foshnja ose formula pasuese.

c) “Mbajtëse” kuptohet çdo formë paketimi i produktit të përcaktuar për shitje si një njësi për shitje me pakicë, duke përfshirë edhe ambalazhin.

ç) “Produkt i përcaktuar për shitje” kuptohet :

- Formulë për foshnjat, e cila nënkupton qumështin ose një produkt të ngjashëm me qumështin, me origjinë shtazore ose bimore, i përgatitur industrialisht, që tregtohet për ushqimin e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël, nga lindja deri në gjashtë muaj.

- Formulë pasuese, e cila nënkupton qumështin ose një produkt të ngjashëm me qumështin, me origjinë shtazore ose bimore, i përgatitur industrialisht, që tregtohet si ushqim për foshnjat dhe fëmijët mbi gjashtë muajsh.

- shishet ushqyese dhe biberonët.

- Çdo produkt tjetër, i shitur për ushqimin e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël.

d) “Foshnjë” kuptohet një fëmijë nga dita e lindjes deri në 12 muaj.

dh) “Fëmijë i vogël” kuptohet një fëmijë nga mosha në 12 muaj deri 3 vjeç.

e) “Tregtim” është promovimi, shpërndarja, shitja, reklama, marrëdhëniet me publikun dhe informimi për zëvendësuesit e qumështit të gjirit.

Kufizimet

Neni 3

Asnjë person nuk duhet të prodhojë, të shpërndajë, të shesë, të magazinojë ose të ekspozojë për shitje produkte të përcaktuara në nenin 2 pika ç të këtij ligji, kur ato:

- nuk janë të regjistruara në përputhje me ligjet në fuqi;
- kanë arritur datën e skadimit;
- nuk janë në mbajtëset e tyre origjinale.

Neni 4

(Shtuar 2 togfjalësia me ligjin nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

Prodhuesve dhe shitësve u ndalohet reklama dhe promovimi i produkteve të përcaktuara në nenin 2 pika ç, duke përfshirë këtu paraqitjen speciale, vizuale në ekrane, edhe nëpërmjet internetit e mediave sociale, reklamat për ulje çmimi, çmimet stimuluese, shitjet speciale, ulje çmimi me kushte të veçanta apo dhurata, kampione të produkteve të caktuara, si dhe promovimi i tyre në një qendër shëndetësore apo institucion tjetër të sistemit shëndetësor shtetëror ose privat.

Neni 5

(Shtuar fjalë në shkronjën "a" me ligjin nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

Ndalohet një prodhues ose një person i ngarkuar nga ai, si dhe çdo shitës:

- a) t'u dhurojë ose shesë institucioneve shëndetësore shtetërore dhe private produktet e përcaktuara në nenin 2 pika ç, me çmim më të ulët se çmimet e publikuara nga prodhuesit;
- b) të dhurojë ose të shpërndajë, brenda një qendre shëndetësore, pajisje ose të ofrojë shërbime, si dhe materiale promovuese, që u referohen ose mund të nxisin përdorimin e një produkti, të përcaktuar sipas nenit 2 pika ç, me përjashtim të rasteve kur kategorizohen si ndihma humanitare;
- c) t'u ofrojë shpërblime, dhurata, kontribute punonjësve të shëndetësisë, të angazhuar me shëndetin e nënës dhe të fëmijës;
- ç) të sponsorizojë veprimtari, pavarësisht nga forma e tyre, që lidhen me shëndetin e nënës dhe të fëmijës, përjashtuar veprimtaritë me karakter të mirëfilltë shkencor.

Neni 6

Çdo punonjësi të shëndetësisë, që punon në institucionet shëndetësore shtetërore dhe/ose private, i ndalohet:

- a) të pranojë shpërblime, dhurata, kontribute nga një prodhues, shpërndarës ose çdo person tjetër i ngarkuar prej tyre;
- b) të pranojë ose të shpërndajë monstra të këtyre produkteve;
- c) të promovojë përdorimin e produkteve të përcaktuara në nenin 2 pika ç, përjashtuar rastet e veçanta, kur ka tregues absolut për përdorimin e tyre, duke shpjeguar qartë edhe pasojat që sjellin ato.

Kufizimet e lidhura me etiketat e formulave foshnjore

Neni 7

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

Një prodhues, shpërndarës ose shitës nuk duhet të ofrojë për shitje ose të shesë formula pasuese, në qoftë se ambalazhi ose etiketa nuk përmban formulimin:

“Ushqimi i gjirit është ushqimi ideal për rritjen e shëndetshme dhe për zhvillimin e fëmijëve. KUJDES! Ky produkt do të përdoret për foshnjat nën 6 muajshe. Përpara se të vendosësh të plotësosh ose të zëvendësosh ushqimin e gjirit me këtë produkt, këshillohu me mjekun!”

Mënyra e paraqitjes, formati dhe përmbajtja e etiketimit të produkteve të përcaktuara në këtë nen miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

Një prodhues, shpërndarës ose shitës nuk duhet të ofrojë për shitje ose të shesë formula pasuese, në qoftë se :

a) ambalazhi ose etiketa nuk përmban fjalët :

“Ushqimi i gjirit është ushqimi ideal për rritjen e shëndetshme dhe për zhvillimin e fëmijëve. Kujdes! Ky produkt do të përdoret për foshnjat mbi 6 muajshe. Përpara se të vendosësh të plotësosh ose të zëvendësosh ushqimin e gjirit me këtë produkt, këshillohu me mjekun!”;

b) etiketa nxit të ushqyerit artificial.

Mënyra e paraqitjes, formati dhe përmbajtja e etiketimit të produkteve të përcaktuara në këtë nen miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

Një prodhues ose shpërndarës nuk duhet të ofrojë për shitje ose të shesë qumësht të skremuar apo të kondensuar në formë pluhuri ose të lëngët, apo qumësht standard e të skremuar si zëvendësues të qumështit të gjirit.

Në ambalazhin e këtyre produkteve duhet detyrimisht të shkruhet:

“Ky produkt nuk duhet të përdoret për ushqimin e foshnjave!”

Mënyra e paraqitjes, formati dhe përmbajtja e etiketimit të produkteve të përcaktuara në këtë nen miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Detyrat e sistemit shëndetësor

Neni 10

Drejtuesit e qendrave shëndetësore dhe autoritetet shëndetësore, vendore dhe kombëtare, duhet të nxisin, të mbështesin dhe të mbrojnë, në kuptim të këtij ligji, të ushqyerit me gji dhe të bëjnë publike mangësitë e mëdha që krijojnë të ushqyerit alternativ.

Neni 11

(Ndryshuar me ligjin nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

1. Prodhuesit dhe shpërndarësit e produkteve të caktuara nuk lejohen të prodhojnë ose të shpërndajnë materiale informative ose edukative për ushqyerjen e foshnjës dhe fëmijës, përfshirë edhe informacionet që i adresohen publikut të gjerë, pa marrë miratimin, paraprakisht, nga struktura përkatëse e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

2. Elementet kryesore të përmbajtjes së materialeve edukative dhe informuese për ushqyerjen e foshnjës dhe fëmijës, përfshirë informacionet që i adresohen publikut të gjerë, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Elementet kryesorë të materialeve informative, për produkte të caktuara, në adresë të profesionistëve të shëndetësisë, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 12

(Ndryshuar fjalia e dytë me ligjin nr. 58/2013, datë 14.2.2013)

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Kundërvajtjet

Neni 13

(Ndryshuar paragrafët e fundit me ligjin nr. 58/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 53/2016, datë 19.5.2016)

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) shkelja e nenit 3, shitja e produkteve që nuk janë regjistruar në përputhje me ligjet në fuqi, shitja e produkteve që kanë kaluar datën e skadimit ose shitja e produkteve që nuk janë në mbajtëset e tyre origjinale, dënohen me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje, propozohet heqja e licencës së dhënë nga organet kompetente;

b) shkelja e nenit 4, nga ana e prodhuesve dhe shitësve, dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

c) shkelja e nenit 5, nga ana e prodhuesve dhe shitësve, dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë, në varësi të shkeljeve të përcaktuara në këtë nen;

ç) shkelja e nenit 6, nga punonjësit e shëndetësisë që punojnë në institucione shëndetësore, publike ose private, dënohet me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje, propozohet masa “Largim nga detyra”;

d) shkelja e neneve 7, 8 e 9, nga prodhuesit, shpërndarësit ose shitësit dënohet me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje, propozohet heqja e licencës së dhënë nga organet kompetente.

Masa e gjobës është dënim kryesor, kur parashikohet si dënim më vete, dhe dënim plotësues, kur jepet njëkohësisht me masën e heqjes së licencës.

Ankimi ndaj vendimit të Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjobat e vjela, sipas këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 14

Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë të nxjerrë aktet nënligjore në lidhje me kufizimet dhe përgjegjësitë e përdorimit të produkteve të përcaktuara në këtë ligj, si dhe për problemet lidhur me edukimin dhe promovimin e strukturave shëndetësore.

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar në ligjin nr. 58/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2452, datë 5.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani